**GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË**
**23 shkurt 2012** **AC.nr.822/2011**

**GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË** në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja Civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA, si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtarja kosovare MEDIHA JUSUFI dhe Gjyqtari kosovar NEHAT IDRIZI, si anëtarë të trupit gjykues,

*Në lendën civile* të paditësës SLAVICA DUKIĆ nga PRISHTINA, e zëvendësuar pas vdekjes së saj gjatë procedures nga MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ si trashëgimtarët e saj ligjor, të gjithë të përfaqësuar nga BOJANA ĐUROVIĆ nga BEOGRADI, Republika e Serbisë, dhe avokati DOBRICA LAZIĆ nga BRESJE, Komuna e FUSHË KOSOVËS kundër të paditurit BASHKIM SOPJANI nga fshati LUMI I MADH, Komuna e VUSHTRISË, përfaqësuar nga avokati HASAN REXHA nga PRISHTINA, për anulim të kontratës së shitëblerjes së banesës me bazë ligjore, neni 124 i Ligjit mbi mardhëniet detyrimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 29/78, 39/85, 45/89, 57/89 dhe Gazeta Zyrtare e RFJ-së Nr. 31/93) ("LMD') dhe dorëzimi i posedimit të kësaj banese me bazë ligjore të nenit 93 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera sendore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 57/2008) ("LPDTS"),

*Duke* pranuar ankesën BASHKIM SOPJANIT kundër aktgjykimit C.nr.1451/04 të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS, të datës 16 shtator 2010 me të cilën kërkesëpadia më lartë ishte aprovuar,

*Pas* këshillimit dhe votimit në seancë të trupit gjykues sipas nenit 190, paragrafi 1, hipoteza e parë e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/2008) ("LPK") të mbajtur më 23 shkurt 2012,

*Me anë të kësaj* sipas nenit 195, paragrafi 1, pika c) dhe neni 198, paragrafi 2 i LPK merr si më poshtë

# AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur nga BASHKIM SOPJANI nga fshati LUMI I MADH, Komuna e VUSHTRRISË, është **APROVUAR** dhe aktgjykimi C.nr.1451/2004 i Gjykatës Komunale në PRISHTINË, i datës 16 shtator 2010 **ËSHTË ANULUAR** me dërgim të lëndës në gjykatë të shkallës së parë për ri-gjykim.

# ARSYETIM

## I. Historiati procedural

**1.** Me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1451/2004 të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS, të datës 16 shtator 2010, ishte aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ si trashëgimtarë ligjorë të së ndjerës SLAVICA DUKIĆ – kontrata mbi shitëblerjen e banësës

Vr.nr.4725/02, e datës 23 gusht 2002 e lidhur ndërmjet SLAVICA DUKIĆ si shitëse, në njërën anë, dhe BASHKIM SOPJANI si blerës, në anën tjetër, ishte anuluar; ky i paditur ishte i obliguar të liroj banesën dhe t'i dorëzoj në posedim të vet paditësve brenda 15 ditëve të periudhës kohore nga hyrja në fuqi e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm; i padituri ishte i obliguar të kompensoj paditësve për shpenzimet e tyre procedurale në shumë prej 1 216.80 Euro.

**2.** Sipas nenit 110, paragrafi 1, fjalia e parë dhe neni 155, paragrafi 2 i LPK ky aktgjykim iu ishte njoftuar palëve përmes dorëzimit të kopjeve të tij tek përfaqësuesit e tyre të autorizuar – për paditësit avokati DOBRICA LAZIĆ më 24 shtator 2010, dhe BOJANA ĐUROVIĆ më 21 tetor 2010, ndërsa për të paditurit - avokati HASAN REXHA më 9 nëntor 2010.

**3.** Më 11 nëntor 2011, avokati HASAN REXHA në emër të BASHKIM SOPJANIT ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit C.nr.1451/04 të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS, të datës 16 shtator 2010 duke e ankimuar atë në baza të *shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore* sipas nenit 182 të LPK, *vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike* sipas nenit 183 të LPK, si dhe *zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale* sipas nenit 184 të LPK. Në mënyrë alternative kërkoi që aktgjykimi: 1) të ndryshohet me prapësim të plotë të padisë si e papranueshme apo e pabazuar; apo 2) të anulohet me dërgim të lëndës në gjykatë të shkallës së parë për ri-gjykim dhe vendim meritor.

**4.** Siç është paraparë me nenin 187, paragrafi 1 i LPK, ankesa është dërguar për përgjigje brenda 7 ditëve te paditurve përmes përfaqësuesve të tyre – më 2 shkurt 2011 avokates DOBRICA LAZIĆ dhe më 8 shtator 2011 tek BOJANA ĐUROVIĆ. Asnjë përgjigje nuk është paraqitur brenda afatit ligjor. Pas skadimit të saj, ankesa në dosje të lëndës është dërguar nga Gjykata Komunale e PRISHTINËS sipas nenit 188, paragrafi 1 i LPK.

## II. Kompetenca e Trupit Gjykues e Gjykatës së Qarkut të PRISHTINËS

5. AC.nr.822/11 e Gjykatës së Qarkut të PRISHTINËS ishte caktuar bazuar në nenin 5, paragrafi 1, pika c) e Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në KOSOVË ("Ligji Nr.03/L-053 mbi Kompetencat") (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/08) përmes aktvendimit të lëshuar më 15 dhjetor 2011 nga Gjyqtarja e EULEX-it duke vepruar si e deleguar e Presidentit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it sipas vendimit ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2696/ff/11, të datës 25 nëntor 2011. Pas administrimit të marrjes së procedurës së paraparë nga neni 5, paragrafi 7, fjalia e parë e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat dhe neni 3, paragrafi 6, fjalia e parë e Udhëzimeve për Përzgjedhje të Lëndëve dhe Caktim të Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në Lëndët Civile, të miratuara nga Asambleja e 17 e Gjyqtarëve të EULEX-it më 16 nëntor 2011 (" Udhëzimet" ), me aktvendim të Deleguarit të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 19 janar 2012 në pajtim

me nenin 5, paragrafi 7, fjalia e dytë e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat dhe neni 3, paragrafi 8 i Udhëzimeve, AC.nr.822/11 iu ishte caktuar Trupit Gjykues të përzier prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut të PRISHTINËS sipas nenit 5, paragrafët 2 të Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat me Gjyqtaren Civile të EULEX-it si kryesuetare të trupit gjykues. Pas derogimit të pjesës më të madhe nga vendimi ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2466/ff/11 të Kryetarit të Asamblesë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 25 nëntor 2011 në pajtim me nenin 5, paragrafi 5 i Ligjit Nr.03/L053 mbi Kompetencat, gjyqtarët kosovarë – anëtarët e trupit gjykues janë caktuar bazuar në nenin 4, paragrafi 3 i Udhëzimeve nga vendimin Agj.nr.16/12 të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në PRISHTINË, të datës 20 janar 2012.

6. Në mënyrë ligjore i përbërë në pajtim me kriteret specifike të nenit 5, paragrafët 1, 2, 4, 5 dhe 7 të Ligjit Nr.03/L053 mbi Kompetencat, ky trup gjykues i Gjykatës së Qarkut të PRISHTINËS është i autorizuar të vendos AC.nr.822/11 bazuar në kompetencën funksionale të gjykatës së shkallës së dytë, të paraparë nga dispozitat e përgjithshme të nenit 15, paragrafi 2 dhe neni 176, paragrafi 3 i LPK.

## III. Pranueshmëria e ankesës dhe e procedurës së shkallës së dytë

7. Nuk ekzistojnë pengesa procedurale për vendosjen e ankesës. *Në vend të parë,* parashtresa e saj nuk është e ndaluar por qartazi e paraparë me nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK si vendim i gjykatës ankimore është aktgjykim i shkallës së parë sipas meritave të kontestit. *Në vend të dytë,* ankesa nuk është e vonuar sipas kushteve të nenit 186, paragrafi 2 i LPK. Aktgjykimi C.nr.1451/2004 i Gjykatës Komunale të PRISHTINËS, i datës 16 shtator 2009 iu ishte dorëzuar avokatit HASAN REXHA, përfaqësues i autorizuar i të paditurve në lëndën e shkallës së parë, më 9 nëntor 2010. Ankesa ishte dërguar me postë më datën 11 nëntor 2010, duke u konsideruar data e parashtrimit të saj në gjykatë – neni 127, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK, para afatit kohor prej 15 ditëve, të paraparë me nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK, ka skaduar më 16 nëntor 2010. *Në vend të tretë,* ankesa nuk është e palejueshme sipas nenit 186, paragrafi 3 i LPK – është paraqitur nga avokati HASAN REXHA , si person i duhur i autorizuar nga BASHKIM SOPJANI i cili duke qenë i paditur në shkallë të parë ka të drejtën procedurale dhe interes juridik për të paraqitur atë. Asnjë refuzim apo tërheqje nuk është deklaruar nga ai. *Në vend të katërt* ankesa ka përmbajtjen e nevojshme sipas nenit 179, paragrafi 1 i LPK. Prandaj, nuk ka baza ligjore për të përjashtuar pranueshmërinë e ankesës dhe/apo procedurën e shkallës së dytë sipas nenit 176 – 205 të LPK të iniciuar nga ajo.

## IV. Përmbledhje e procedurës së shkallës së parë

8. Më 10 qershor 2004, SLAVICA DUKIĆ nga PRISHTINA ka paraqitur padi kundër BEKIM SOPJANI dhe BASHKIM SOPJANI, të dy nga ata nga fshati LUMI I MADH, Komuna e VUSHTRRISE. Paditësi pohoi që i padituri i parë e ka mashtruar vetën si person në gjendje të liroj banësën e saj, me vendndodhje në PRISHTINË, "ULPIANA" C-7, hyrja 10, nr.3, me sipërfaqe prej 49.89 m$^2$, nga uzurpuesi i saj. Për

këtë qëllim, BEKIM SOPJANI ka kërkuar autorizim, i dhenë nga SLAVICA DUKIĆ me autorizim Vr.nr.4518/2002, i vërtetuar nga Gjykata Komunale e PRISHTINËS më 14 gusht 2002. Gjoja se, ishte përgaditur nga BEKIM SOPJANI dhe ishte nënshkruar nga SLAVICA DUKIĆ pa e lexuar përmbajtjen e saj. Në një bashkëbisedë disa ditë më vonë, ata u pajtuan që autorizimi të mbetet i plotëfuqishëm kështu që BEKIM SOPJANI do të mund të gjente një bleres, të shes pronën, të i dorëzoj SLAVICA DUKIĆ çmimin dhe të shpërblehet për shërbimin e tij me pagesën e duhur. BEKIM SOPJANI e ka përdorur autorizimin e njëjtë për të lidhur në emër të SLAVICA DUKIĆ si shitëse kontratën mbi shitblerjen e banesës me vëllain e tij BASHKIM SOPJANI si blerës, të vërtetuar nga Gjykata komunale e PRISHTINËS si Vr.nr.4725/02 më 23 gusht 2002. Ai i ka mbajtur të hollat nga shitblerja, duke e mos informuar SLAVICA DUKIĆ. Kërkesëpadia ishte kontrata e sipërpërmendur për të u anuluar, kështu që nuk ka mundur të jep efekt juridik.

9. Padia ishte paraqitur në Gjykatën komunale të PRISHTINËS sikurse të nënshkruar nga SLAVICA DUKIĆ. Me autorizim, të datës 3 janar 2006, të bashkangjitur në lëndë, ajo e ka autorizuar DOBRICA LAZIĆ, avokate nga BRESJE, të përfaqësoj atë në kontest.

10. Me autorizim, të datës 10 maj 2006, të paraqitur në lëndë, BEKIM SOPJANI dhe BASHKIM SOPJANI avokat i autorizuar HASAN REXHA nga PRISHTINA të përfaqësoj ata në C.nr.1451/2004 të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS.

11. Paditësja SLAVICA DUKIĆ ka vdekur më 18 prill 2006. Megjithatë gjykata nuk ishte informuar deri më 22 qershor 2007, procedura ka vazhduar pa ndërprerje dhe duke u marrë nga pasardhësit e saj ligjor. Në procedurat e seancës kryesore më 30 maj dhe 7 shtator 2006 të pranishëm ishin avokati DOBRICA LAZIĆ në emër të tashmë të të ndjeres SLAVICA DUKIĆ, dhe avokati HASAN REXHA për dy të paditurit BEKIM SOPJANI dhe BASHKIM SOPJANI.

12. Më 22 qershor 2007, avokatja DOBRICA LAZIĆ ka paraqitur parashtresë në lëndën që SLAVICA DUKIĆ ka vdekur më 18 prill 2006 dhe si trashëgimtarë të saj për banesen e kontestuar kanë qenë të shpallur MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ, djemtë dhe vajza, që do të mernnin përsipër procedurën. E bashkangjitur në këtë parashtresë ishte certifikata e vdekjes e lëshuar nga Komuna OBRENOVAĆ–SMZ nr.17 më 20 prill 2006 që SLAVICA DUKIĆ, e lindur më 22 mars 1948 në PRISHTINË që ka vdekur më 18 prill 2006 në BORIĆ, OBRENOVAČ. Gjithashtu e paraqitur me parashtresë ishte vendimi T.nr.120/2007 i Gjykatës komunale OBRENOVAĆ, të datës 13 mars 2007, sipas të cilës trashëgimia e të ndjerës SLAVICA DUKIĆ e përbërë nga banesa e kontestuar dhe deri në vlerë të saj si trashëgimtarë ligjorë të shkallës së parë janë deklaruar MILE DUKIĆ (i biri), MILAN DUKIĆ (i biri) dhe MIRJANA RADAKOVIĆ (e bija) me 1/3 të pjesës trashëgimore për çdonjërin nga ata.

**13.** Në seancën kryesore më 26 shtator 2007, MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ, të paftuarit mungonin. Pa autorizim me shkrim të paraqitur në lëndë, avokatja DOBRICA LAZIĆ ka marrë pjesë në seancë në emër të tyre, *inter alia*, duke kërkuar ndryshim të fushës subjektive të padisë si pasojë e vdekjes së paditëses fillestare SLAVICA DUKIĆ.

**14.** Avokatja DOBRICA LAZIĆ ka vazhduar pjesëmarrjen e saj në procedurën e seancës kryesore pasuese më 1 nëntor 2007, 15 prill 2008, 17 qershor 2008, 4 gusht 2008 dhe 17 dhjetor 2008, për MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ pa autorizim me shkrim për përfaqësimin e tyre në lëndë. Kjo ishte vërtetuar nga gjykata në seancën kryesore më 19 maj 2010 kur avokatja DOBRICA LAZIĆ ka paraqitur autorizimet në emër të tij të dhenë nga MIRJANA RADAKOVIĆ më 4 mars 2010, nga MILE DUKIĆ më 11 mars 2010 dhe nga MILAN DUKIĆ më 17 mars 2010, të gjitha në kopje. Autorizimet e shkallës së parë dhe të dytë janë paraqitur në origjinal më 30 qershor 2010, ndërsa e treta më 8 shtator 2010.

**15.** Më 1 qershor 2009, MILE DUKIĆ ka paraqitur kërkesë për përjashtim të gjyqtarës OLGA JANIĆIJEVIČ, fillimisht e caktur në lëndë e arsyetuar me mos caktimin e ndonjë seance në seancë të saj prej 2008 dhe pjesërisht në zgjidhjen e kontestit. Më 8 korrik 2008, gjyqtarja OLGA JANIĆIJEVIČ e ka informuar kryetari i Gjykatës komunale të PRISHTINËS, duke e arsyetuar pezullimin në seancë pas 18 dhjetorit 2008 dhe gjithashtu duke kërkuar përjashtim të saj nga lënda. Asnjë aktvendim sipas nenit 70, paragrafi 1 i LPK të Kryetarit të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS nuk ishte marrë në bazë të kërkesës për përjashtimin e saj. Megjithatë, lënda ishte *de facto* e vazhduar nga gjyqtari TIHOMIR MIKARIĆ në seancat më 19 maj 2010, 30 qershor 2010 dhe 8 shtator 2010. Në seancën e fundit avokatja DOBRICA LAZIĆ tërhoqi padinë që ka të bëj me BEKIM SOPJANIN, gjithashtu siç është e ka specifikuar atë në lidhje me BASHKIM SOPJANIN duke kërkuar kontratën e ankimuar për të anuluar, dhe ky i paditur të obligohet të liroj banesën dhe ti dorëzoj atë në posedim paditësve.

**16.** Me aktgjykimin C.nr.1451/04 të GJK të PRISHTINËS, të datës 16 shtator 2010 kërkesëpadia ishte aprovuar në tërësi siç është formuluar në seancën e fundit menjëherë para përfundimit të seancës së shkallës së parë.

## V. Shqyrtimi i ankesës së gjykatës së shkallës së dytë sipas nenit 194 të LPK

### *Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore – Neni 182 të LPK*

**17.** Arsyeja e *parë* procedurale sipas nenit 181, paragrafi 1, pika a) e LPK në ankesë është për lëshimin e aktgjykimit të ankimuar nga gjykata, jo të përbërë në mënyrë të duhur – *shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sipas nenit 182, paragrafi 2, pikat a) dhe c) të LPK.* C.nr.1451/04 të PRISHTINËS ishte regjistruar më 10 qershor 2004. Fillimisht iu ishte caktuar *trupit gjykues me gjyqtaren OLGA JANIĆIJEVIČ si kryetare e trupit gjykues dhe dy gjyqtarëve porotë* sipas nenit 42, paragrafi 1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore ("Gazeta Zyrtare e RSFJ-së" Nr.

4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90, 27/90, 35/91 dhe "Gazeta Zyrtare e RSS" Nr. 27/92, 31/93, 24/94, dhe 12/98) (LPK 1977), Neni 8 dhe neni 9, paragrafi 1 i Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta ("Gazeta Zyrtare e KSAK" Nr. 21/78, 49/79, 44/82, 44/84, 18/87, 14/88). Pas hyrjes në fuqi të LPK më 30 tetor 2008, e dëshmuar nga procesverbali i seancave në seancën kryesore më 17 dhe 18 dhjetor 2008, *gjyqtarja OLGA JANIĆIJEVIČ vazhdoi për të vendosur këtë lëndë civile si gjyqtare e vetme* sipas nenit 15, paragrafi 1 në lidhje me nenin 532, paragrafi 1 i LPK. Më 1 qershor 2009, MILE DUKIĆ paraqiti kërkesë Kryetarit të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS për përjashtim të saj për shkak të mos caktimit të vazhdueshëm të seancave prej vitit 2008 dhe anësinë e plotë në zgjidhjen e kontestit. Kërkesa ishte paraqitur më 1 qershor 2009 para përfundimit të seancës kryesore më 8 shtator 2010, brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 68, paragrafi 1 i LPK. I kishte parakushtet sipas nenit 68, paragrafi 3 dhe 4 i LPK – emrin e gjyqtarit dhe arsyet sipas nenit 67, pika g) e LPK për përjashtim. Mos pranueshmëria sipas nenit 69, paragrafi 1, pikat a) – c) të LPK, nuk ka mundur të hedhet poshtë nga gjyqtarja OLGA JANIĆIJEVIČ si ushtruese në lëndën bazuar në nenin 69, paragrafi 2 i LPK. Si pasojë, në pajtim me nenin 71, paragrafi 1 i LPK ajo ndërpreu punën e saj në padi dhe më 8 korrik 2009 informoi Kryetarin e Gjykatës komunale të PRISHTINËS. Kjo e fundit nuk e ka marrë në ndonjë moment aktvendimin mbi këtë kërkesë për përjashtim sipas nenit 70, paragrafi 1 i LPK në formë të shkruar të paraparë me nenin 160, paragrafi 1 në lidhje me nenin 175 të LPK pas pyetjeve paraprake të parapara sipas nenit 70, paragrafi 4 i LPK. Kështu procedura e përjashtimit kishte qenë vetëm e filluar, por jo e kryer dhe/apo e finalizuar siç është kërkuar ligjërisht me aktvendim të Kryetarit të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS i marrë në bazë të nenit 70, paragrafi 1 i LPK. Në mungesë të saj, gjyqtari TIHOMIR MIKARIĆ nuk ka mundur të emërohet si zëvendësues në procedurën e saj të ardhshme. Kjo *"bartje"* e lëndës ndërmjet atyre nuk ishte vendosur përmes përjashtimit me aktvendim të kryetarit të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS sipas nenit 70, paragrafi 1 i LPK si *i vetmi akt gjyqësor i lejueshëm* për ri-caktimin e tij. I mungon atij *gjithashtu baza ligjore normative* – seanca më 19 maj, 30 qershor dhe 8 shtator 2010 nga gjyqtari TIHOMIR MIKARIĆ nuk ka mundur të arsyetohet me nenin 71, paragrafi 2 i LPK pasi që nuk janë mbajtur për *veprime procedurale urgjente nga gjyqtari me përjashtimin e kërkuar sipas nenit 67, pika g) të LPK.* Duke e përmbledhur, gjyqtarja OLGA JANIĆIJEVIČ, fillimisht e caktuar në C.nr.1451/04, pas 1 qershorit 2009 pa qenë e përjashtuar ndërpreu gjykimin e lëndës dhe ishte *de facto* e zëvendësuar në procedurën pasuese pa bazë ligjore nga gjyqtari TIHOMIR MIKARIĆ. Ky i fundit vendosi lëndën edhe pse akoma iu ishte caktuar gjyqtares OLGA JANIĆIJEVIČ, ajo nuk kishte qenë e përjashtuar me përjashtim në bazë të nenit 67, pika g) e LPK dhe nuk ka pasur të emëruar zëvendësim për të finalizuar procedurën. Si pasoj kjo *de facto* dorëzimi i lëndës, pa *ri-caktim ligjor,* aktgjykimi ishte marrë nga gjykata i përbërë në mënyrë jo të duhur për shkak të ndryshimeve të paautorizuara në përbërjen e saj personale – shkelja thelbësore brenda nenit 182, paragrafi 2, pika a) e LPK.

18. Arsyeja e *dytë* procedurale sipas nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK në ankesë është për përfaqësim të paligjshëm të SLAVICA DUKIĆ nga avokatja DOBRICA LAZIĆ si shkelje thelbësore brenda nenit 182, paragrafi 2, pika k) e LPK. Ai nuk është i bazuar. Padia ishte paraqitur më 10 qershor 2004, e nënshkruar nga SLAVICA DUKIĆ – pasi që ky veprim procedural ishte ndërmarr personalisht nga pala në pajtim me nenin 89, paragrafi 1 i LPK 1977, asnjë autorizim për kryerje të tij nuk ishte lëshuar në pajtim me nenin 94 të LPK 1977 dhe e prezantuar në lëndë në pajtim me nenin 97, paragrafi 1 i LPK 1977. Më 3 janar 2006, SLAVICA DUKIĆ nënshkroi autorizimin, duke e autorizuar avokaten DOBRICA LAZIĆ për të përfaqësuar atë në kontestin tashmë në pritje në Gjykatën Komunale të PRISHTINËS. Pasi që ky autorizim ishte dhenë i përgjithshëm, fusha e tij përfshinte të gjitha veprimet në procedurë siç është paraparë nga neni 95, paragrafi 1 i LPK 1977. Të pabazuara së këndejmi janë pretendimet e ankuesit që avokatja DOBRICA LAZIĆ ka vepruar në lëndë pa qenë e autorizuar nga paditësi fillestar – padia është dorëzuar personalisht nga SLAVICA DUKIĆ, ndërsa për të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra deri më 18 prill 2006, avokatja DOBRICA LAZIĆ e ka përfaqësuar atë bazuar në autorizimin e datës 3 janar 2006, brenda fushës së nenit 94, paragrafi 1 i LPK 1977. Gjithashtu nuk ka shkelje lidhur me pjesëmarrjen e SLAVICA DUKIĆ në seancë – ajo ka marrë pjesë në seancën e parë më 3 janar 2006, ndërsa prania e saj në tjetrën më 14 mars 2006 nuk ka qenë mandatore – Neni 295 LPK 1977. Në kundërshtim me pretendimet e palës ankuese, në shkallë të parë nuk ishte vendosur që SLAVICA DUKIĆ të dëgjohet si palë sipas nenit 264, paragrafi 1 LPK 1977 dhe ajo kurrë nuk është ftuar në një seancë të tillë sipas nenit 268 LPK 1977. Megjithatë, kjo nuk ka mundur të kualifikohet si lëshim procedural – *së pari* asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk ka bërë një propozim të tillë dëshmues sipas nenit 219 LPK 1977; *së dyti,* kjo seancë ishte fakultative në pajtim me nenin 264 LPK 1977; *së treti,* në bazë të nenit 269, paragrafi 1 i LPK 1977 asnjë palë nuk mund të detyrohet të dëshmoj apo të dënohet për dështim për të iu përgjigjur ftesës gjyqësore. Më pak fjalë, mungesa e SLAVICA DUKIĆ në seanca në intervalin 10 prill 2004 – 18 prill 2004 dhe mos dëgjimi i saj si palë nuk ka shkelur rregullën e procedurës sipas nenit 182, paragrafi 2, pika k) LPK.

19. Arsyeja e *tretë* sipas nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK është i ndërlidhur me vdekjen e paditësit gjatë procedurës dhe është e konstatuar. *Në vend të parë,* C.nr.1451/04 e Gjykatës Komunale të PRISHTINËS ishte iniciuar më *10 qershor 2004,* SLAVICA DUKIĆ ka vdekur më *18 prill 2006,* e dëshmuar me certifikatë të vdekjes të Komunës OBRENOVAĆ nr.17, e datës 20 prill 2006, derisa gjykata është informuar për vdekjen e saj me parashtresë të avokates DOBRICA LAZIĆ e paraqitur më *22 qershor 2007.* Kështu për më shumë se një vit (nga 18 prilli 2006 deri më 22 qershori 2007) C.nr.1451/04 e Gjykatës Komunale të PRISHTINËS ishte gjykuar në lidhje me SLAVICA DUKIĆ si palë ndërgjyqëse megjithatë me vdekjen e saj ajo e ka humbur zotësinë procedurale sipas nenit 79, paragrafi 1 i LPK 1977 të jetë palë në lëndë. Kjo është një shkelje absolute brenda nenit 182, paragrafi 2, pika (k) e LPK –

128



në shkallë të parë për veprimet procedurale të një periudhë të vazhdueshme kohore janë kryer në lidhje me SLAVICA DUKIĆ dhe në emër të saj edhe vdekjen e saj më 18 prill 2006 ajo automatikisht e ka humbur statusin e paditëses. *Në vend të dytë* C.nr.1451/04 të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS nuk ishte ndërprerë sipas nenit 212, pika 1 LPK 1977, apo neni 277, pika a) LPK (pas hyrjes së saj në fuqi më 30 tetor 2008) megjithatë kjo ndërprerje ishte mandatorë pasi që pala kishte vdekur dhe trashëgimia e saj procedurale në lëndë duhej të rregullohej. *Në vend të tretë,* trashëgimtarët e SLAVICA DUKIĆ kurrë nuk kanë kërkuar të marrin procedurën pas vdekjes së saj, megjithatë në mënyrë imperative ishte kërkuar me nenin 215, paragrafi 1 LPK 1977, dhe neni 280, paragrafi 1 i LPK. Kjo nuk mund të atribuohet në parashtresën e avokates DOBRICA LAZIĆ të datës 22 qershor 2007 – ishte paraqitur para autorizimeve të saja për përfaqësim në lëndën nga MIRJANA RADAKOVIĆ, nga MILE DUKIĆ dhe nga MILAN DUKIĆ, përkatësisht të datës 4, 11 dhe 17 mars 2010. Asnjë kërkesë e këtij lloji nuk më është bërë mua personalisht nga ata me shkrim apo gojarisht në ndonjë seancë pas 18 prillit 2006. Në mungesë të saj *per argumentum ad contrario* të nenit 215, paragrafi 1 i LPK 1977, dhe neni 280, paragrafi 1 i LPK, lënda nuk ka mundur të vendoset me pjesëmarrje të MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ – ata qartazi nuk kanë kërkuar nga gjykata të vazhdoj procedurën e iniciuar nga SLAVICA DUKIĆ pas vdekjes së saj dhe si pasojë nuk ka fituar statusin e saj të *pasardhësve procedural.* Ata kanë vepruar në C.nr.1451/04 duke mos qenë të *caktuar si paditës, duke e zëvendësuar atë të ndjerën fillestare* në kundërshtim me nenin 215, paragrafi 1 LPK 1977, dhe neni 280, paragrafi 1 i LPK – shkelje procedurale të kualifikohet sipas nenit 182, paragrafi 2, pika (k) LPK.

**20.** Arsyeja e *tretë* sipas nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK lidhur me përfaqësimin e MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ nga avokatja DOBRICA LAZIĆ është gjithashtu e bazuar. *Në vend të parë,* autorizimi i lëshuar nga SLAVICA DUKIĆ më 3 janar 2006 në emër të avokatës DOBRICA LAZIĆ për të përfaqësuar atë në lëndën me vdekjen më 18 prill 2006 është bërë e pa plotëfuqishme *ex legës* sipas nenit 95 në lidhje me nenin 532, paragrafi 1 LPK. Ky anulim i autorizimit si pasoj e vdekjes së personit fizik duke i dhenë atë është ngjashëm i paraparë me nenin 94, paragrafi 3, LMD. Efekti i saj juridik nuk ka mundur të konsiderohet i rezervuar sa i përket trashëgimtarëve të SLAVICA DUKIĆ – LPK nuk parasheh një vazhdim të tillë të vlefshmërisë së autorizimit pas vdekjes së palës – personi fizik i cili e ka lëshuar atë, ndërsa mundësia sipas nenit 94, paragrafi 3 *in fine* LMD nuk është i aplikueshëm për përfaqësimin procedural. *Në vend të dytë* avokatja DOBRICA LAZIĆ ka vepruar në procedurë *në emër të trashëgimtarëve SLAVICA DUKIĆ pa autorizime* për pothuajse 3 vite – nga 22 qershor 2007 kur ai e ka informuar gjykatën për emrat e tyre deri kur janë lëshuar autorizimet në emër të tij nga MIRJANA RADAKOVIĆ më 4 mars 2010 nga MILE DUKIĆ më 11 mars 2010, nga MILAN DUKIĆ më 17 mars 2010, dhe origjinalet e tyre janë prezantuar në lëndë më 30 qershor 2010. Brenda këtij intervali kohor avokatja DOBRICA LAZIĆ është

paraqitur në lëndë si përfaqësuese me prokurë të MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ pa qenë me të vërtetë e autorizuar për të përfaqësuar këto palë, në kundërshtim me kriteret mandatorë të Kapitullit VI të LPK 1977, i aplikueshëm deri më 30 tetor 2008 dhe Kapitulli V LPK, i aplikueshëm pas asaj date. Sipas nenit 94, paragrafi 1 i LPK 1977, si dhe neni 89 dhe neni 90, paragrafi 1 i LPK *vetëm pala ka të drejtë të autorizoj përfaqësuesin e saj dhe fusha e autorizimit për të gjithë apo veprime të caktuara në procedurë me autorizim me shkrim me autorizim të avokatit apo verbalisht në proces* ashtu siç është paraparë nga neni 97, paragrafi 1 i LPK 1977 dhe neni 92, paragrafi 1 i LPK. Sipas nenit 98, paragrafi 1 i LPK 1977 dhe neni 93, paragrafi 1 i LPK *autorizimi duhet të bëhet zyrtarisht dhe të paraqitet në lëndë qysh në veprimin e parë të ndërmarrë nga përfaqësuesi.* Në shkelje të këtyre rregullave C.nr. 1451/04 Avokatja DOBRICA LAZIĆ ka vepruar më shumë se 3 vite për pasardhësit e SLAVICA DUKIĆ pa qenë të caktuar si përfaqësues të tyre sipas nenit 94, paragrafi 1 i LPK 1977 apo neni 90, paragrafi 1 i LPK me autorizim të rregullt të lëshuar me shkrim sipas nenit 97, paragrafi 1 i LPK 1977 apo neni 92, paragrafi 1 i LPK, i parashkruar për vlefshmërinë e tyre, i paraqitur në lëndë sipas nenit 98, paragrafi 1 i LPK 1977 dhe neni 93, paragrafi 1 LPK. Përfaqësimi i avokatës DOBRICA LAZIĆ për trashëgimtarët e SLAVICA DUKIĆ ishte vërtetuar kur origjinalët e autorizimit janë paraqitur në lëndë më 30 qershor 2010 për MILE DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ dhe më 8 shtator 2010 për MILAN DUKIĆ. Deri atëherë, pa autorizime, e dëshmuar në procedurë, avokatja DOBRICA LAZIĆ *de facto* ka marrë pjesë në lëndë duke mos qenë *de jure* me të drejtë për të vepruar për këto palë ndërgjyqëse. Pasi që zotësia e fituar në mënyrë të rregullt e përfaqësuesit të autorizuar është parakusht për vlefshmërinë e të gjitha veprimeve procedurale të ndërmarra në emër të palëve (Neni 92 i LPK 1977; Neni 86, paragrafi 2 LPK), ato të avokatës DOBRICA LAZIĆ për MILE DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ deri më 30 qershor 2010 dhe për MILAN DUKIĆ dhe 8 shtator 2010 ishin jo të vlefshme, pa efekt ligjor (Neni 90 i LPK 1977; neni 86, paragrafi 1 i LPK). *Në vend të tretë,* shkalla e parë ka lejuar pjesëmarrjen e avokatës DOBRICA LAZIĆ në lëndë për pothuajse 3 vite pa kërkuar nga ajo të paraqes autorizimet e humbura nga paditësit apo pëlqimin e tyre për veprimet procedurale të ndërmarra, brenda periudhës së parashkruar kohore siç është kërkuar nga neni 98, paragrafi 2 i LPK 1977 dhe neni 93, paragrafi 2 LPK. Për pjesën thelbësore të procedurës, shkalla e parë nuk ka përmbushur gjithashtu detyrën e saj sipas nenit 98, paragrafi 4 i LPK 1977 dhe neni 93, paragrafi 4 i LPK për të kontrolluar *ex officio* nëse avokatja DOBRICA LAZIĆ paraqitja për paditësit ishte me të vërtetë e autorizuar nga ndonjëri nga ata. Ka gabime procedurale që kanë mbetur të pakorrigjuara - MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ nuk e kanë dhenë pëlqimin e tyre me veprimet e avokatës DOBRICA LAZIĆ në lëndë para lëshimit të autorizimeve në emër të tij më 4, 11 dhe 17 mars 2011 dhe parashtresa e origjinaleve të tyre në lëndë më 30 qershor 2010 dhe 8 shtator 2010. E nënshkruar me përmbajtje minimale sipas nenit 89 të LPK, ato ishin autorizimet e përgjithshme për të ndërmarrë veprimet *e ardhshme* në procedure me *ex*

*nunc* vetëm me efekt juridik. Nuk ka pëlqim të përfshirë *ex tunc* të paditësve me veprimet e *kaluara* procedurale të avokatës DOBRICA LAZIĆ në autorizim të datës 4, 11 dhe 17 mars 2011. Një konfirmim i tillë nuk është shprehur me shkrim në ndonjërin nga dokumentet e paraqitura nga paditësit në lëndë apo verbalisht në ndonjërën nga seancat e saja. Asnjë marrveshje nuk është deklaruar nga BOJANA ĐUROVIĆ, bazuar nga autorizimi i nënshkruar nga MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA më 25 dhjetor 2006, gjatë paraqitjes së saj të parë në seancë më 19 maj 2010 apo më pastaj. Veprimet e pa autorizuara të avokatës DOBRICA LAZIĆ në lëndë kurrë nuk janë aprovuar nga palët në pajtim me nenin 98, paragrafi 4, fjalia e dytë *in fine* LPK 1977 apo neni 93, paragrafi 4, fjalia e dytë *in fine* LPK si instrument i vetëm ligjor për vlefshmërinë e tyre retroaktive. Ato nuk janë stabilizuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale të PRISHTINËS më 30 qershor 2010 për të për të hedhur poshtë anulimin e tyre si të paligjshëm sipas nenit 93, paragrafi 4, fjalia e dytë *in fine* LPK duke kërkuar këto veprime procedurale të personit të pa autorizuar, jo të miratuara nga palët, të anulohet. E njëjta e marrë *pa autorizimet e duhura me shkrim* sipas nenit 97, paragrafi 1 LPK 1977 apo neni 92, paragrafi 1 LPK në emër të avokates DOBRICA LAZIĆ për MILE DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ deri më 30 qershor 2010 dhe për MILAN DUKIĆ dhe 8 shtator 2010 si *e pa vërtetuar nga palët apo e anuluar nga shkalla e parë* më vonë në procedurë siç është parapärë nga neni 98, paragrafi 4, fjalia e dytë *in fine* LPK 1977 apo neni 93, paragrafi 4, fjalia e dytë *in fine* LPK, përbën shkelje procedurale sipas nenit 182, paragrafi 2, pika k) LPK, që plotëson aprovimin e ankesës.

**21.** Arsyeja e *pestë* sipas nenit 181, paragrafi 1, pika a) në lidhje me nenin 182, paragrafi 2, pika n) LPK është i ndërlidhur me gabimet e aktgjykimit që nuk kanë mundur të shqyrtohen. Është provuar gjithashtu. C.nr.1451/2004 të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS ishte iniciuar nga padia e SLAVICA DUKIĆ si paditëse kundër BEKIM SOPJANI dhe BASHKIM SOPJANI si të paditur për anulim të kontratës së shitblerjes të banësës Vr.nr.4725/2002, të vërtetuar nga Gjykata Komunale e PRISHTINËS më 23 gusht 2002. Në seancën e fundit më 8 shtator 2010, avokatja DOBRICA LAZIĆ *ka tërhequr* padinë në lidhje me BEKIM SOPJANIN dhe *specifikoi* deklaratën e vet në lidhje me BASHKIM SOPJANIN duke kërkuar përveç anulimit të kontratës, ky i paditur të obligohet të liroj banesën dhe ti dorëzoj në posedim të saj paditësve. Kjo kërkesë është e pa lejueshme. *Në vend të parë, kërkesa për dorëzim të pronës së paluajtshme* sipas nenit 113 LPDTS, që buron nga baza faktike dhe ligjore, ndryshe nga ajo padi fillestare për anulim të kontratës, *nuk ishte bashkuar në një padi* siç është parapärë me nenin 255, paragrafi 2 LPK, por është dorëzuar pasi që lënda kishte filluar më 10 qershor 2004, në seancën e fundit kryesore më 8 shtator 2010. Të paditurve nuk iu ishte dhenë e drejta të përgjigjen në këtë padi të re sipas nenit 395 LPK, të paraqes fakte për refuzim të saj dhe/apo të propozoj prova që dëshmojnë vërejtjet e tyre në këtë kontest siç është parapärë me nenin 396 LPK. Për të gjitha këto arsye, dëbimi nuk ka mundur të zgjidhet nga shkalla e parë pasi që prezantimi i saj në fund të seancës ishte në aspektin procedural i pa rregullt

dhe i dëmshëm në të drejtat e të paditurve. *Në vend të dytë,* nuk ka mundur të konsiderohet i paraqitur në pajtim me nenin 2, paragrafi 1 LPK përmes *ndryshimit të padisë* sipas nenit 257, paragrafi 1 LPK. Prej 8 shtatorit 2010 seanca paraprake tashmë është lidhur, ndërsa seanca kryesore është iniciuar. Në atë shkallë procedurale padia nuk ka mundur lirshëm të ndryshohet në asnjërën nga alternativat sipas nenit 258, paragrafi 1 LPK, duke ditur që *mungesa e pëlqimit të paditurve* në mënyrë mandatorë kërkohej nga neni 258, paragrafi 2 *in fine* LPK. *Në vend të tretë,* pasi që padia fillestare i kishte të gjitha parakushtet sipas nenit 253, paragrafi 1 në ndërlidhje me nenin 99, paragrafi 1 i LPK, nuk ka mundur të korrigjiohet apo të përfundohet sipas nenit 102, paragrafi 2 LPK. Veç kësaj, procedura nuk ka mundur të përdoret për parashtrim të *padisë së veçantë të re mbi dëbimin* pasi që ajo nuk paraqet korrigjim apo përfundim të *tashmë padisë fillestare të paraqitur për anulim të kontratës.* Prandaj, kërkesa e avokates DOBRICA LAZIĆ *"për të precizuar padinë"* ligjërisht nuk ka mundur të arsyetohet me nenin 253, paragrafi 1, neni 102, paragrafi 2 apo neni 257, paragrafi 1 në lidhje me nenin 258, paragrafi 2 LPK si padi fillestare e mbetur *e pandryshueshme,* ndërsa *lënda e rastit ishte zgjeruar në mënyrë të paligjshme në fund të seancës* pa pëlqimin e të paditurve dhe pa vendosje mbi dëbimin. *Në vend të pestë* në pjesën përmbledhëse, dispozitivi dhe deklarata mbi bazat e aktgjykimit, MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ janë caktuar si paditës, megjithatë kushtet sipas nenit 280, paragrafi 1 LPK për fitimin e këtij statusi procedural bazuar në trashëgiminë e tyre ligjore me SLAVICA DUKIĆ pas vdekjes së saj më 18 prill 2006 nuk janë plotësuar (shih pjesën 21 më lartë). Më pastaj BASHKIM SOPJANI paraqitet si i vetmi i paditur, megjithatë procedura sa i përket BEKIM SOPJIANIT nuk ka mundur të konsiderohet e anuluar. Në seancën kryesore më 8 shtator 2010, avokatja DOBRICA LAZIĆ ka tërhequr padinë kundër BEKIM SOPJIANIT. Ky i fundit as personalisht, e as përmes avokatit HASAN REXHA nuk e ka dhenë *pëlqimin* e tij me këtë tërheqje *në mënyrë të qartë* sipas nenit 261 paragrafi 2, fjalia e parë LPK, apo *në mënyrë të kuptueshme* sipas nenit 261, paragrafi 2, fjalia e dytë LPK. Nuk është lëshuar asnjë aktvendim nga Gjykata komunale e PRISHTINËS për tërheqje të padisë në pajtim me nenin 261, paragrafi 3 LPK dhe kështu procedura në pjesën përkatëse ka mbetur në pritje. Duke e përmbledhur, aktgjykimi ishte marrë bazuar në deklaratën e avokatës DOBRICA LAZIĆ në seancën e datës 8 shtator 2010, që duke qenë e pa pranueshme nuk e ka ndryshuar në mënyrë valide lëndën e rastit dhe palët ndërgjyqëse në procedurë. Si pasojë, aktgjykimi në mënyrë të gabuar përcakton *konstestin nën vendosje, statusin procedural të trashëgimtarëve të SLAVICA DUKIĆ si paditës të rinjë* pa fituar siç është kërkuar nga neni 280, paragrafi 1 LPK dhe *legjitimiteti pasiv* i BASHKIM SOPJANI si i paditur i vetëm, megjithatë procedura për BEKIM SOPJIANIN nuk është anuluar sipas nenit 261, paragrafi 3 LPK. Të gjitha këto gabime procedurale të numëruara të aktgjykimit bien nën fushën e nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK.

**22.** Shkeljet procedurale sipas nenit 182, paragrafi 2, pikat a), k), dhe n) LPK të paraqitura në ankesë ekzistojnë. Asnjë shkelje e tillë sipas nenit 182, paragrafi 2, pikat

b), g), j) dhe m) LPK ku gjykata e shkallës së dytë është e obliguar të shqyrtoj *ex officio* janë përcaktuar. Aktgjykimi ishte marrë mbi padinë që bie në kompetencat territoriale të Gjykatës komunale të PRISHTINËS të paraparë nga neni 53 LPK (*neni 182, paragrafi 2, pika b) LPK).* Nuk ishte i bazuar në dispozitën e paligjshme të palëve sipas nenit 3, paragrafi 3 LPK (*Neni 182, paragrafi 2, pika g) LPK).* Palëve ndërgjyqëse nuk iu është mohuar e drejta e interpretimit në gjuhën e tij/saj (*Neni 182, paragrafi 2, pika j) LPK).* Publiku i garantuar nga neni 444, paragrafi 1 LPK nuk ishte përjashtuar në seanca (*Neni 182, paragrafi 2, pika m) LPK).*

***Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike – Neni 183 LPK***

**23.** Arsyeja *e dytë* në ankesë është sipas nenit 181, paragrafi 1, pika b) LPK për *vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.* Është i bazuar sipas kriterit të nenit 183, paragrafi 1 i LPK.

**24.** Është vërtetuar në aktgjykimin e ankimuar që me *autorizim me shkrim,* të vërtetuar nga Gjykata Komunale në PRISHTINË Vr.nr.4518/2002 më 14 gusht 2002, SLAVICA DUKIĆ e ka autorizuar BEKIM SOPJANI në emër të saj të lidh kontratën mbi shitblerjen për banesën, e cila gjendet në PRISHTINË, "ULPIANA" C-7, hyrja 10, nr.3, me sipërfaqe të përgjithshme prej 49.89 $m^2$. Personi i autorizuar kishte të drejtë të bartë pronën tek personi i tretë, të nënshkruaj kontratën mbi shitjen e saj në gjykatën kompetente, si dhe të kryej veprimet e tjera të nevojshme lidhur me banesën. Ekzistimi i autorizimit të tillë në mënyrë të qartë ishte pranuar nga SLAVICA DUKIĆ në padi sipas nenit 221, paragrafi 1 LPK 1977. Ishte propozuar si dëshmi në seancën paraprake më 30 maj 2006 dhe ishte procesuar si e tillë në seancën kryesore më 19 maj 2010. *Nënshkrimi* i SLAVICA DUKIĆ, i vërtetuar nga Gjykata komunale e PRISHTINËS si Vr.nr.4518 më 14 gusht 2002 me efekt obligues dëshmues sipas nenit 230 paragrafi 1 LPK 1977 (Neni 329, paragrafi 1 LPK) kurrë nuk është vërtetuar si jo i vërtetë sipas nenit 230, paragrafi 3 LPK 1977 (Neni 329, paragrafi 3 kurr nuk ishte vërtetuar si jo i vërtetë sipas nenit 230, paragrafi 3 LPK 1977 (Neni 329, paragrafi 3 LPK). Lëshimi i saj *me shkrim, i vërtetuar nga gjykata* nuk ishte kontestuar dhe origjinali kurrë nuk është kërkuar sipas nenit 108, paragrafi 3 LPK 1977 (Neni 101, paragrafi 3 LPK). *Përmbajtja e* autorizimit nuk përmban kryqe, fshirje, vendosje ndërmjet rreshtave, korrigjime dhe lëshime të tjera të jashtme duke përjashtuar vlerën e saj dëshmuese. *Fusha* e saj është vërtetuar nga SLAVICA DUKIĆ sa i përket tipit të transaksionit ligjor që të lidhet në bazët (të shitblerjes) dhe pronës për të u shitur. Asnjë konstatim faktik sa i përket këtij autorizimi, megjithatë e pohuar në padi, janë të përfshira në aktgjykim që është jo përfundimi i gjendjes së saj faktike sipas nenit 183, paragrafi 1 i LPK.

**25.** Nuk është e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë që më 23 gusht 2002 Gjykata Komunale e PRISHTINËS e ka vërtetuar sipas Vr.nr.4725/02 kontrata mbi shitblerjen e banesës së lidhur nga SLAVICA DUKIĆ si shitëse përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar BEKIM SOPJANI, në njërën anë, dhe BASHKIM SOPJAINI si

blerës, në anën tjetër. Në bazë të pikave të saj I dhe II, SLAVICA DUKIĆ si pronare e banesës në PRISHTINË, "ULPIANA" C-7, hyrje 10, nr.3, me sipërfaqe prej 49.89 $m^2$, në bazë të kontratës së shitblerjes, të vërtetuar në Gjykatës Komunale të PRISHTINËS sipas Vr.nr.8185/93 më 14 shtator 1993, i ka shitur atë BASHKIM SOPJANI, ndërsa ai e ka blerë atë për çmimin prej 31 000 €. Në pikën III ishte pajtuar që më datën e lidhjes së kontratës posedimi i banesës të dorëzohet nga shitësi dhe çmimi i saj të paguhet nga blerësi.

26. Një jotërësi tjetër faktike sipas nenit 183, paragrafi 1 LPK është i ndërlidhur me *pagesën e faturës, të datës 3 shtator 2009.* Me lëshimin e saj SLAVICA DUKIĆ *pranoi* që si shitëse e banesës në PRISHTINË, "ULPIANA" C-7, hyrja 10, nr.3, me sipërfaqe prej 49.89 $m^2$, pranoi më 3 shtator 2002 nga blerësi BASHKIM SOPJIANI çmimin e plotë prej 31 000 €. Në fund emrat e këtyre palëve janë të shtypura dhe nënshkrimet përkatëse janë të shkruara me dorë. Fatura ishte propozuar nga avokati HASAN REXHA si dëshmi në seancën paraprake më 30 maj 2006 dhe e marrë në seancë kryesore më 19 maj 2010. Origjinali i saj nuk ishte kërkuar sipas nenit 108, paragrafi 3 LPK 1977 apo neni 101, paragrafi 3 LPK për të vërtetuar kopjen e saj në lëndë, që është pa gabime të jashtme. Palët, përshkrimi i banesës dhe çmimi i shitblerjes siç është përmendur në mënyrë të qartë në faturë *përkon me ato në kontratën e anikumuar.* Pra, nuk është e dyshimt që dëftesa/fatura është lëshuar për përmbushjen e saj. Ajo në mënyrë grumbulluese paraqet: a) një *dokument*-Neni 232, paragrafi 1 LPK 1977 (Neni 331, paragrafi 1 LPK); dhe b) *pranimi* i palës – neni 221, paragrafi 1 LPK 1977 (Neni 321, paragrafi 2 LPK). Kjo *dëshmi e pranueshme dhe relevante*, me *vlerë dëshmuese speciale* sipas nenit 321, paragrafi 1 LMD për përmbushjen e obligimeve, nuk është konsideruar nga gjykata e shkallës së parë fare. Nuk është kontrolluar nga ekspertiza e mjekësisë ligjore sipas nenit 319, paragrafi 3 LPK megjithatë në seancë më 4 gusht 2008 MILE DUKIĆ e kontestoi si jo të vërtetë nënshkrimin e SLAVICA DUKIĆ në dëftesë. Si rezultat i të gjitha këtyre heqjeve në kundërshtim me nenin 322, paragrafi 1 LPK shkalla e parë ka konkluduar mos pagesën e saj me *rregullën e materialit dëshmues* sipas nenit 322, paragrafi 2 LPK, megjithatë ajo ka mundur të vërtetohet me *këtë dëshmi të paraparë specifike* , e marrë në lëndë.

27. Analizat faktike të deklaratave të paditurit BASHKIM SOPJANI janë gjithashtu jo precize. *Në vend të parë,* atyre iu është dhenë në seancë më 17 qershor 2008 për të cilën paditësit MILE DUKIĆ, MILAN DUKIĆ dhe MIRJANA RADAKOVIĆ nuk ishin ftuar, nuk ishin prezentë dhe nuk ishin përfaqësuar në mënyrë të rregullt siç është cekur në pjesën 22 më lartë. Prandaj, seanca është dashur të shtyhet – Neni 294 LPK 1977. Kryerja e saj me parregullsi të tilla zhvleftëson të gjitha veprimet procedurale të marra në atë drejtim. *Në vend të dytë,* përveç kësaj parregullsie të përgjithshme, deklaratat e avokatit HASAN REXHA në seancë më 17 qershor 2008 nuk është dashur të merren parasysh në shqyrtimin sipas nenit 8 LPK fare, pasi që *ato nuk janë dëshmi.* Duke qenë *përfaqësues i autorizuar* i paditësve, ky

134



avokat nuk mund të konsiderohet i dëgjuar si *palë* sipas nenit 264, paragrafi 1 LPK 1977. Për arsye të njëjtë, deklarata e tij nuk përfaqëson pranim të palës sipas nenit 221, paragrafi 1 i LPK 1977. Në seancën e datës 17 qershor 2008 avokati HASAN REXHA *nuk ka marrë pjesë si dëshmitar–* ai nuk ishte ftuar për marrje në pyetje sipas nenit 235 dhe neni 242 LPK 1977; ai nuk ishte informuar për detyrat e tija për të treguar të vërtetën dhe/apo paralajmëruar për pasojat e dëshmimit të dëshmisë së rrejshme siç është paraparë me nenin 243, paragrafi 1 LPK 1977; ai nuk ishte i informuar për të drejtat e tija për të refuzuar të dëshmoj faktet që kanë ardhë në dijeni të tij si avokat sipas nenit 237, paragrafi 2 i LPK 1977. Pa pajtim me të gjitha këto kritere, avokati HASAN REXHA *nuk ka fituar statusin procedural të dëshmitarit.* Së këndejmi, përgjigjet e tija në pyetjet e gjykatës në seancën e datës 17 qershor 2008 *nuk përbëjnë dëshmitë e dëshmitarit.* Pasi që ato nuk mund të kualifikoheshin ligjërisht si dëshmi, bazuar në ato shkalla e parë nuk ka mundur të mosbesoj deklaratat e BASHKIM SOPJANI, të dëgjuar në këtë seancë. *Në vend të katërt,* gjatë seancës paraprake më 30 maj 2006 avokati HASAN REXHA në emër të paditurve iu është përgjigjur në padi, *inter alia,* që pasi që dëftesa e pagesës ishte nënshkruar nga SLAVICA DUKIĆ në zyrën e tij, ai ka mundur të konfirmoj të vërtetën në përmbajtjen e saj, por ai nuk ishte në dijeni çfarë kishte ndodhur ndërmjet palëve më pastaj. Kjo ishte *deklaratë procedurale* sipas nenit 287, paragrafi 1 i LPK 1977 të përfaqësuesit të autorizuar të paditësve për refuzim të padisë, *pa vlerë dëshmuese* sipas nenit 220, paragrafi 1 i LPK 1977. Nuk ka mundur të përdoret për konstatimet faktike në kontest, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo jo të drejtëpërdrejtë. Për të gjitha këto arsye palejueshmëria e shkallës së parë ka marrë parasysh deklaratat e avokatit HASAN REXHA në seancat më 30 maj 2006 dhe 17 qershor 2008 si" *provë*" , megjithatë duke i munguar një vlerë dëshmuese e tillë. *Në vend të pesë,* përveç asaj, ato ishin gjeneralizuar *si tërësisht kontraverzale* , megjithatë ato përkojnë në faktin që dëftesë pagesa ishte nënshkruar personalisht nga SLAVICA DUKIĆ në zyrën e avokatit HASAN REXHA pasi që çmimi iu ishte paguar asaj. Më 17 qershor 2008 BASHKIM SOPJANI deklaroi që ai i ka paguar të hollat SLAVICA DUKIĆ një javë apo dy pasi që kontrata në zyrën e avokatit HASAN REXHA, prezent atje, i cili e ka hartuar dëftesën me shkrim në Gjuhën serbe, të nënshkruar nga palët me Letërnjoftim të SLAVICA DUKIĆ e kopjuar në anën e pasme. Sa i përket avokatit HASAN REXHA, më 17 qershor 2008, jashtë çdo procedure për mbledhjen e provave, iu përgjigj gjykatës që ai e ka hartuar dëftesën, vulosur atë me nënshkrim, pas palëve, të dy prezent në zyrën e tij, konfirmoi pagesën e çmimit dhe nënshkroi dëftesën personalisht me shkrim. Nuk është me rëndësi nëse ishte i nxënë me punë atë ditë, avokati HASAN REXHA ka dëshmuar vetë pagesën e çmimit. Me rëndësi është që SLAVICA DUKIĆ ka konfirmuar që më 3 shtator 2002 ajo ka pranuar nga BASHKIM SOPJANI çmimin e plotë për banesën në shumë prej 31 000 Euro duke nënshkruar me të personalisht dëftesën, të përgaditur nga HASAN REXHA. Në motivet e gjykatës së shkallës së parë, *momenti i pagesës së çmimit* është gabim i përzier në *momentin e nënshkrimit të dëftesës,* megjithatë faktikisht ato nuk janë

identike dhe *koincidenca e tyre nuk është mandarore me ligj.* Sipas nenit 321, paragrafi 1 i LMD përmbushja e obligimit nga debitori duhet të verifikohet nga dëftesa e lëshuar nga kreditori. Pa kriterin e saktë nga kjo apo tjetra dispozitë, lëshimi i saj mund të jetë *i njëhershëm* me përmbushjen e obligimit apo *si pasojë* e asaj, pa ndonjë afat ndalues.

**28.** Bazuar në këto shqyrtime, gjendja faktike në aktgjykimin e ankimuar duhet të kualifikohet si *jo i plotë* dhe *i gabuar* sipas nenit 183, paragrafi 1 LPK. Gjykata e shkallës së parë *ka dështuar të vërtetoj të gjitha faktet,* të pretenduara në padi në kundërshtim me nenin 319, paragrafi 2 LPK, nga provat e pa vlerësuara, vendimtare për padinë. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu *në mënyrë të gabuar ka vërtetuar faktet e tjera,* të pretenduara nga përgjigjja në padi, duke e përjashtuar dëgjimin e të padidurit sipas nenit 264, paragrafi 1 LPK 1977 me deklaratat përfaqësuesi i tij i autorizuar *pa vlerë dëshmuese dhe duke i përzier konstatimet e veta për lëshim të dëftesës me ato të pagesës së çmimit, të verifikuara me të.* Arsyeja sipas nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK e paraqitur në ankesë është arsyetuar dhe vërteton aprovimin e saj.

***Zbatim i gabueshëm i të drejtës materiale – Neni 184 LPK***

**29.** Sipas nenit 194 të LPK trupi gjykues do të shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar brenda ankesës, si dhe *ex officio* për *zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale* sipas nenit 184 LPK.

**30.** Gjykata e Shakllës së parë nuk ka aplikuar ndonjërën nga dispozitat e të drejtës materiale të aplikueshme në autorizim, të nënshkruara nga SLAVICA DUKIĆ për BEKIM SOPJANI më 14 gusht 2002. *Në vend të parë,* lëshimi i saj për lidhjen e kontratës së atakuar përmes përfaqësuesit është qartazi e njohur nga neni 84, paragrafi 1 i LPK si i lejueshëm. Megjithatë *e mos bazuar në ligj* apo *një veprim i organit kompetent,* sipas nenit 84, paragrafi 2 LPK, përfaqësimi në mënyrë të rregullt është vërtetuar nga autorizimi i mësipërm, duke shprehur vullnetin e SLAVICA DUKIĆ si person që i jep këtë kompetencë BEKIM SOPJANI për të ushtruar atë si person i autorizuar (me prokurë) – Neni 89, paragrafi 1 LPK. Ekzistimi dhe fushëveprimi i këtij autorizimi në pajtim me nenin 89, paragrafi 2 LMD *është i pavarur* nga ndonjë transaksion ligjor i mundshëm duke shërbyer si bazë për lëshimin e saj. Prandaj, e ka prodhuar efektin e vet juridik sipas nenit 84, paragrafi 2 LMD, pa marrë parasysh për lidhjen e *kontratës mbi urdhrin* sipas nenit 749, paragrafi 1 LMD, *kontrata e komisionit* sipas nenit 771, paragrafi 1 LMD apo *çfardo kontratë tjetër* duke e obliguar BEKIM SOPJANIN për të shitur banesën e SLAVICA DUKIĆ, me apo pa kompenzim. *Në vend të dytë,* forma me shkrim e vërtetuar nga gjykata, e paraparë me nenin 4, paragrafi 2 i Ligjit mbi Tregtimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e RSS Nr. 43/81, 24/85, 28/87, 6/89 dhe 40/89) ("LTPP") si mandatorë për të gjitha kontratat e bartjes së të drejtave mbi pronat të paluajtshme, e aplikueshme gjithashtu për autorizimin për lidhjen e tyre sipas nenit 90 LMD është zbatuar. Autorizimi për

shitjen e ankimuar është nënshkruar nga SLAVICA DUKIĆ me shkrim me vërtetimin nga Gjykata Komunale në PRISHTINË si Vr.nr.4518/02 më 14 gusht 2002. E lëshuar në formë të paraparë nga neni 90 LMD në ndërlidhje me nenin 4, paragrafi 2 LTPP, është me efekt juridik, dhe sanksioni në nenin 70, paragrafi 1 LMD për mungesë të kësaj forme të nevojshme nuk është e aplikueshme. *Në vend të tretë,* pretendimet në padi për *ndryshime verbale të njëhershme* të autorizimit nuk janë dëshmuar nga paditësit në pajtim me nenin 319, paragrafi 1 LPK. Së këndejmi, fushëveprimi i saj nuk ka mundur të konsiderohet i kufizuar në dëbim prej banesës bazuar në nenin 71, paragrafi 2 LMD dhe *autorizimi është i vlefshëm vetëm me përmbajtje, i përfshirë në dokument* , e presupozuar si komplete nga neni 71, paragrafi 1 LMD. Pasi që nuk janë dëshmuar në lëndë *ndryshime verbale pasuese* asnjëra nga kushtet e tyre nuk është marrë si e ndryshuar sipas nenit 67, paragrafi 3 LMD. Kështu BEKIM SOPJANI ka pasur të drejtë të ndërmarr veprimet juridike *brenda fushëveprimit të autorizimit* sipas nenit 91, paragrafi 1 LMD, siç është paraparë në dokumentin e saj zyrtar – neni 71, paragrafi 1 LMD. Ajo specifikon veprimin ligjor për të u marrë - lidhja e kontratës, lloji i saj – shitja, dhe banese për shitje në PRISHTINË, "ULPIANA" C-7, hyrja 10, nr.3, me sipërfaqe prej 49.89 $m^2$. Prandaj BEKIM SOPJANI ishte në *veçanti* i autorizuar siç kërkohej nga neni 91, paragrafi 3 LMD të lidh në emër të SLAVICA DUKIĆ shitblerjen e kësaj prone të paluajtshme pa kufizime sa i përket blerësit të saj, çmimit apo kushteve të tjera. *Në vend të katërt,* asnjëra nga mungesat e vullnetit të SLAVICA DUKIĆ në dhënien e autorizimit, të pretenduar në padi, megjithatë pa dallim të qartë, janë dëshmuar nga paditësit siç është paraparë nga neni 319, paragrafi 1 LPK. Nuk është marrë asnjë provë për *gabimin e saj thelbësor* sipas nenit 61, paragrafi 1 LMD sipas statusit të banesës, personi – i autorizuari i saj për shitje të saj dhe/apo rrethanat e tjera vendimtare për autorizimin. Nuk *ka gabim në motivet* e SLAVICA DUKIĆ sipas nenit 62, LMD është vërtetuar në lëndë, domethënë lidhur me aftësitë e BEKIM SOPJANI për të liruar banesën nga uzurpuesi i saj. Autorizimi është lëshuar pa *keqkuptim* sipas nenit 63 LMD sa i përket llojit të kontratës për të u lidhur në emër të saj dhe subjektit të saj. E pa dëshmuar në këtë lëndë është gjithashtu pretendimi që BEKIM SOPJANI ka mashtruar SLAVICA DUKIĆ me *mashtrim* sipas nenit 65, paragrafi 1 LMD. Pa këtë vullnet mungesat, autorizimi nuk ka mundur të shfuqizohet – neni 61, paragrafi 2 LMD, mendohet të mos jetë i lëshuar – neni 63 LMD apo i anuluar – Neni 63, paragrafi 3 LMD . *Në vend të pestë,* pa ndonjë limit kohor sipas nenit 77 LMD apo kusht të anulimit neni 74, paragrafi 3 LMD, ishte revokuar me parashtresën e paraqitur nga SLAVICA DUKIĆ në Gjykatën Komunale në PRISHTINË më 8 qershor 2004 sipas nenit 92, paragrafët 1 dhe 2 LMD. Kështu ishte anuluar *ex munc,* duke mos pasur efekt retroaktiv për kontratën e ankimuar të lidhur më 23 gusht 2002, para këtij revokimi më 8 qershor 2004, me BASHKIM SOPJAINI si person i tretë në pajtim me nenin 93, paragrafi 1 LMD. Duke e përmbledhur, autorizimi ishte lëshuar nga personi fizik pa mungesë të vullnetit, në formën e përshkruar, me nevojë të veçantisë për bartje të paluajtshmërisë. Ajo prodhon efektin e saj ligjor me lëshimin e saj më 14 gusht 2002 – neni 89, paragrafi 1

LMD deri në revokim të saj më 8 qershor 2004 – neni 92, paragrafi 1 LMD, kështu në mënyrë valide duke e legjitimuar BEKIM SOPJANIN si përfaqësues i autorizuar të SLAVICA DUKIĆ në ditën e shitjes së kontestueshme – më 23 gusht 2002.

**31.** Gjykata e Shkallës së parë nuk ka aplikuar dispozitat e të drejtës materiale në vlefshmërinë dhe/apo efektin juridik të kontratës Vr.nr.4725, të vërtetuar nga Gjykata Komunale në PRISHTINË më 23 gusht 2002. *Në vend të parë,* duke pasur bartjen e pronësisë si lëndë e saj, kualifikimi i saj ligjor është *shitja* sipas nenit 454, paragrafi 1 LMD. Është lidhur me *shkrim me vërtetimin nga gjykata* që është formë e parashikuar me statut sipas nenit 4, paragrafi 2 LBPP në ndërlidhje me nenin 67, paragraf 1 *in fine* LMD për të gjitha kontratat e bartjes së pronave të paluajtshme. *Përmbajtja* e saj përfshin *elementet esenciale* të shitjes – 1) *objekti* sipas nenit 458, paragrafi 1 LMD – banesa, e specifikuar me vendndodhjen e saj në adresë dhe sipërfaqe, 2) *çmimi – i përcaktuar nga kontrata* në shumë prej 31 000 € në pajtim me nenin 462, paragrafi 1, hipoteza e parë në lidhje me nenin 394 LMD, *që nuk i nënshtrohet vërtetimit tjetër* me çmimin e përshkruar (Neni 463 LMD), me çmimin aktual të përcaktuar (neni 464 LMD). Me këto elemente përbërëse të pajtuara, në pajtim me nenin 26 LMD kontrata e ankimuar ishte *lidhur* pasi që dokumentit i saj zyrtar ishte nënshkruar nga përfaqësuesi i shitësit në gjykatë më 23 gusht 2002 në pajtim me nenin 72, paragrafi 1 LMD. *Në vend të dytë,* kontrata nuk është e pavlefshme: 1) sa i përket *subjektit* të saj nuk është e pamundshme, e paligjshme, e pa specifikuar apo e pa përcaktuar (neni 47 LMD); 3) *baza e saj* nuk është jo ekzistuese apo e pa lejueshme (neni 52 LMD); 3) palët janë persona fizik me *zotësinë* sipas nenit 2 dhe nenit 54, paragrafi – LMD); 4) asnjëra nga *mungesat e vullnetit* sipas nenit 60-66 LMD kanë ekzistuar sa i përket ndonjërës nga palët; 5) sa i përket *formës* është ajo e nevojshmja, e pa aplikueshme është pavlefshmëria për mungesë të saj sipas nenit 70, paragrafi 1 LMD; 6) Kontrata nuk është nule në kundërshtim me *rregulloret e domosdoshme, parimin publik apo përdorimin e drejtë-* neni 103, paragrafi 1 LMD. Në veçanti, nuk është nule për të qenë e lidhur ndërmjet blerësit në lidhje familjare me përfaqësuesin e shitësit. Ky konfigurim nuk e shkel ndonjë rregullore të domosdoshme dhe nuk e shfuqizon këtë transaksion ligjor. *Në vend të katërt,* e lidhur nga BEKIM SOPJAINI si përfaqësues i autorizuar i shitësit SLAVICA DUKIĆ, brenda kufijve të kompetencës së tij, kjo kontratë ishte detyruese për të si e përfaqësuar dhe pala tjetër kontraktuese – blerësi BASHKIM SOPJANI sipas nenit 85, paragrafi 1 LMD. Ky i fundit ishte informuar për statusin e BEKIM SOPJANI si person i autorizuar pasi që ajo kishte qenë në mënyrë të qartë e treguar në përmbajtjen zyrtare të kontratës, duke e mbajtur atë efektive për të dyja palët kontraktuese sipas nenit 85, paragrafi 3 LMD. BEKIM SOPJANI i ka ushtruar kompetencat e tija si përfaqësues *vet* pa e bartur atë tjetrit – neni 86, paragrafi 1 LMD. Shitja e banesës së kontestueshme ishte lidhur në kufijtë e këtij autoriteti, *pa shkelje* sipas nenit 87, paragrafi 1 LMD. Së këndejmi, asnjë aprovim pasues i të përfaqësueses sipas nenit 87, paragrafët 2 dhe 3 LMD nuk ishte i nevojshëm. Nuk ishte i nevojshëm bazuar në nenin 88, paragrafët 2 dhe 3 LMD gjithashtu kontrata nuk ishte e nënshkruar nga BEKIM SOPJANI në emër të

SLAVICA DUKIĆ, pa autorizim të lëshuar nga ky i përfaqësuar. Prandaj, detyrimi i saj ligjor nuk ka mundur të përjashtohet për shkak të kufijve të kaluar të autoritetit të BEKIM SOPJANI si përfaqësues i SLAVICA DUKIĆ – Neni 87 LMD apo për lidhje nga personi i autorizuar – Neni 88 LMD. I nënshkruar bazuar në autorizimin valid të lëshuar nga shitësi, brenda kufinjëve të tij, kontrata ka hyrë në fuqi me vërtetimin e saj nga gjykata si shitblerje sipas nenit 454, paragrafi 1 LMD të pronësisë së banesës, në efektin e saj ligjor as nulle e as e anulueshme.

**32.** Shkalla e parë në mënyrë fjalë për fjalë në aktgjykim neni 516, paragrafi 1 LMD *duke përcaktuar obligimin e blerësit për të paguar çmimin në kohën dhe vendin e specifikuar në kontratë.* Megjithatë, dështoi të aplikoj këtë dispozitë në mënyrë të duhur. *Në vend të parë,* ishte vetëm mekanikisht e ri-përgaditur në aktgjykim pa ndonjë analizë ligjore të veçantive të padisë konkrete në kundërshtim me nenin 160, paragrafi 5 LPK. *Në vend të dytë,* rregulla për shpërndarje të njëhershëm të posedimit të banesës me pagesën e çmimit të saj në tërësi në ditën e lidhjes së kontratës së formuluar në pikën e saj III siç është paraparë nga neni 516, paragrafi 1 i LMD, duke pasuar nenin 516, paragrafi 2 LMD, nuk është zbatuar fare nga gjykata e shkallës së parë. Sa kohë që SLAVICA DUKIĆ nuk e ka përmbushur obligimin e saj sipas nenit 454, paragrafi 1, neni 467, paragrafi 1 LMD për të dorëzuar si shitës posedimin e banesës BASHKIM SOPJANIT si blerës, më 23 gusht 2002, ditën e lidhjes së kontratës, *i njëjti nuk ishte i obliguar të paguaj çmimin deri sa të mos jetë në gjendje të inspektoj objektin sipas nenit 475 in fine LMD.* Në mënyrë të qartë e ka shtyrë *ex legës* deri në dorëzim të pronës, obligimi i BASHKIM SOPJANIT për pagësë të çmimit sipas nenit 516, paragrafi 1 LMD nuk ka qenë i nevojshme para se ti dorëzohet posedimi i banesës, pasi që përmbushja e saj nuk ka mundur të përmbushet nga kreditori para skadimit të këtij afati kohor – neni 315, paragrafi 1 dhe neni 316 LMD. Si pasojë kjo përjashton dështimin në kryerjen dhe dhe anulimin e kontratës sipas nenit 124 LMD për shkak të një mos kryerje të tillë. *Në vend të tretë,* mos dorëzimi i banesës nga SLAVICA DUKIĆ tek BASHKIM SOPJANI në ditën e lidhjes së kontratës më 23 gusht 2002, siç është paraparë nga pika e saj III dhe neni 467, paragrafi 1 LMD, është *vonesa e kreditorit* të saj sipas nenit 235, paragrafi 2 LMD, që sipas nenit 326, paragrafi 1 LMD *e shkarkon* atë nga të gjitha pasojat ligjore të *vonesës së debitorit* të tij në pagësë të njëhershme të çmimit në datën e njëjtë, duke përfshirë anulimin e kontratës sipas nenit 124 LMD. *Në vend të katërt,* sipas nenit 122, paragrafi 1 LMD me kontrata bilaterale asnjë palë nuk është e obliguar të përmbush obligimet e saja përderisa tjetra nuk i përmbush, apo është gati menjëherë të përmbush obligimin e saj. Duke pasuar rregullën, BASHKIM SOPJANI nuk ishte i obliguar të paguaj çmimin në pajtim me nenin 516, paragrafi 1 LMD me kusht që SLAVICA DUKIĆ nuk i kishte dorëzuar atij banesën e shitur më 23 gusht 2002, e as nuk i kishte ofruar dorëzim të njëhershëm vijues në pajtim me nenin 122, paragrafi 1 dhe neni 467, paragrafi 1 LMD. Asgjë tjetër nuk ishte pajtuar me kontratë, e përcaktuar me ligj apo duke rezultuar nga natyra e transaksionit. Kështu *mos përmbushja nga shitësi e shtyen përmbushjen e blerësit,* e legalizon *vonesën në*

*kufirin kohor të vonuar* për pagësë të çmimit më 23 gusht 2002, e bën këtë obligim të *paligjshëm, e përjashton dështimin e përmbushjes së tij* dhe së këndejmi *mospranimin e* kontratës sipas nenit 124 LMD.

33. Gjykata e shkallës së parë nuk i ka aplikuar dispozitat e të drejtës materiale në *përmbushjen* sipas kapitullit VI, pjesa 2 LMD. Në veçanti, mos implementimi në aktgjykimin e saj është neni 321 LMD, megjithatë i aplikueshëm në padi. Paragrafi i saj pohon që *kushdo që përmbush obligimin në tërësi apo pjesërisht ka të drejtë që kreditori të i lëshoj atij dëftesë në shpenzime të tija*, paragrafi i saj 2 derogon rregullën vetëm për pagësë të borxhit përmes bankës apo postës, paragrafi i saj 3 konsideron që dëftesa e lëshuar për pagësë të plotë të përfaqësuarit i referohet interesit aksesor dhe gjithashtu shpenzimeve. Dëftesa e paraqitur si *dëshmi speciale për përmbushje të të gjitha obligimeve*, përfshirë ato monetare kontraktuese. Prandaj *vlera e saj dëshmuese* mbizotëron mbi atë të ndonjë dëshmie tjetër në kontest për pagësë të çmimit sipas nenit 516, paragrafi 1 LMD. Në kundërshtim me këto rregulla, dëftesa e lëshuar nga nga SLAVICA DUKIĆ më 3 shtator 2002, e marrë në lëndë të shkallës së parë, nuk është shqyrtuar sa i përket vërtetësisë nga ekspertiza e mjekësisë ligjore sipas nenit 319, paragrafi 3 LPK me qëllim të konfirmimit të pagesës të çmimit si fakt, vendimtar në kontest. Më tej, dëftesa, megjithatë duke qenë e pranueshme dhe dëshmi relevante, nuk është konsideruar fare nga gjykata e shkallës së parë siç është kërkuar nga neni 8 LPK. Në deklaratë të arsyeve të aktgjykimit të ankimuar sipas nenit 160, paragrafi 4 LPK nuk është shqyrtuar, vlerësuar apo vërtetuar për ndonjërin nga faktet. Nëse përpunohet pa këto lëshime ligjore, dëftesa e datës 3 shtator 2002 është e mjaftueshme për të verifikuar siç është parapaë nga neni 321, paragrafi 1 LMD përmbushjen e obligimit për pagësë të çmimit sipas nenit 516, paragrafi 1 LMD në pajtim me kushtet e kontratës. *Në vend të parë,* sipas dëftesës çmimi iu është paguar BASHKIM SOPIANI personalisht, që është përmbushja e obligimit *nga debitori* në pajtim me nenin 296, paragrafi 1 LMD. Nuk ka dëshmi të përmbushjes nga *personi i tretë* sipas nenit 296, paragrafët 2-4 LMD, me apo pa bartje të së drejtës të rregulluar nga neni 299 – 304 LMD. *Në vend të dytë,* sipas dëftesës çmimi iu është paguar SLAVICA DUKIĆ, që është përmbushja e *kreditorit* në hipotezën e parë të nenit 305, paragrafi 1 LMD. Çmimi nuk është pranuar nga BEKIM SOPJANI, siç është pretenduar nga padia, që e përjashton çdo mundësi vlefshmërinë e një pagese të tillë për shkak të mospërcaktimit nga kreditori në hipotezën e katërt të nenit 305, paragrafi 1 LMD. *Në vend të tretë,* në bazë të dëftesës *lëndë e përmbushjes* korrespondon me atë të detyrimit sipas nenit 516, paragrafi 1 LMD siç është cekur nga kontrata – është përmbushur si monetare përmes pagesës së çmimit në vlerën e pajtuar monetare dhe zëvendësimin e përmbushjes në alternativa sipas nenit 308 dhe 309 LMD është realizuar. *Në vend të katërt,* sipas dëftesës çmimi sipas nenit 462, paragrafi 1 i LMD siç është përcaktuar në kontratë mbi shitblerjen është paguar *në tërësi.* Kjo e përjashton vlefshmërinë e kësaj pagese si *përmbushje parciale* sipas nenit 310, paragrafi 1 apo paragrafi 2 *in fine* LMD. Shpenzimet mbi bartjen e pronësisë dhe të gjitha shpenzimet e tjera të përmbushuara sipas pikës V të kontratës dhe nenit 298

LMD duhet të mbulohen nga bleresi vetëm në të cilën i përjashton ata nga pagesa për shkak të tij tek shitësi. Pasi që ndërmjet këtyre palëve ka ekzistuar vetëm një obligim monetar për pagesën e çmimit sipas nenit 516, paragrafi 1 i LMD, jo të aplikueshme kanë qenë rregullat për për lejimin e përmbushjes së disa obligimeve të llojit të njëjtë sipas neneve 312 -313 LMD. *Në vend të pestë,* pasi që afati kohor për pagësë të çmimit më 23 gusht 2002, e pajtuar nga pika II e kontratës, për shkak të mos dorëzimit të posedimit të banesës në atë datë ka qenë *ex legës* e vazhduar në momentin e përmbushjes së këtij obligimi të shitësit në pajtim me nenin 475 LMD, pagesa më 3 shtator 2002 megjithatë para skadimit të këtij afati të ri ligjor, në mënyrë të vlefshme është i plotëfuqishëm bazuar në nenin 315, paragrafi 1 LMD. *Në vend të gjashtë,* siç është verifikuar nga dëftesa çmimi ishte paguar më 3 gusht 2002 në PRISHTINË duke qenë në atë kohë banim i kreditorit SLAVICA DUKIĆ. Prandaj, vendi i përmbushjes së këtij obligimi monetar është ai i paraparë me nenin 320, paragrafi 1 LMD. *Në vend të shtatë* dëftesa nuk ka mundur të vërtetohet nga gjykata, siç është përmendur nga MILE DUKIĆ në seancën e datës 4 gusht 2008 pasi që asnjë formë statutore dhe procedurë nuk janë paraparë për këtë lloj të dokumenteve. Sipas nenit 321, paragrafi 1 i LMD lëshimi i saj me shkrim është ligjërisht i mjaftueshëm. Duke e përmbledhur, nëse dëftesa e pagesës së datës 3 shtator 2002 të jetë e konfirmuar si e vërtetë, në pajtim me nenin 321, paragrafi 1 LMD e ka vlerën dëshmuese për të vërtetuar që BASHKIM SOPIANI ka përmbushur obligimin e tij për të paguar çmimin në tërësi të banesës, të supozuar nga kontrata kontestuese. Përmbushja kështu e verifikuar të jetë valide, e ka prish këtë obligim sipas nenit 295, paragrafi 1 LMD që e përjashton *dështimin e kryerjes* si parakusht mandator sipas nenit 124 LMD për anulim të kontratës për shkak të mos kryerjes.

**34.** Vërtetimi i gabuar i të drejtës materiale sipas nenit 184 të LPK, të paraqitur në ankesë dhe kontrolluar *ex officio* nga shkalla e dytë bazuar në nenin 194 LPK, ekziston. Gjykata e shkallës së parë ka dështuar të zbatoj në mënyrë të duhur dispozitat të cilat rregullojnë lidhjen e kontratës së ankimuar, vlefshmërinë e saj, efektin ligjor dhe/apo performancën deri në marrje të vendimit të saj në këtë padi.

## VI. Përfundim

**35.** Bazuar në shqyrtimet e gjykatës së shkallës së dytë do të aprovoj ankesën e BASHKIM SOPJANIT – aktgjykimin C.nr. 1451/04 të Gjykatës Komunale të PRISHTINËS, të datës 16 shtator 2010 do të anulohet sipas nenit 195, paragrafi 1, pika c) LPK si e paligjshme e marrë me arsyet e nenit 181, paragrafi 1, pikat a) – c) LPK, e identifikuar në shqyrtimin e ankesave. Rasti do të kthehet në shkallë të parë për rigjykim sipas nenit 198, paragrafi 2 LPK në pajtim me udhëzimet sipas nenit 198, paragrafi 3 LPK i dhenë më poshtë.

**36.** Statusi procedural i trashëgimtarëve të SLAVICA DUKIĆ si paditës në lëndë duhet të rregullohet bazuar në vendimin mbi trashëgiminë përfundimtare të vërtetuar zyrtarisht dhe kërkesës së tyre të qartë në gjykatë për marrje të procedurës si

pasardhës të saj procedural sipas nenit 280, paragrafi 1 LPK. Tërheqja e padisë kundër të paditurit BEKIM SOPJANI e iniciuar në seancë më 8 shtator 2010 duhet të përfundohet – duke marrë pëlqimin e tij sipas nenit 261, paragrafi 2 i LPK dhe lëshimin e aktvendimit sipas nenit 261, paragrafi 3 LPK. Lënda e kontestit duhet të caktohet në mënyrë të qartë qysh në fillim të rigjykimit, d.m.th.si padi apo paditë të paraqitura në pajtim me nenin 2, paragrafi 1 LPK, i individualizuar me të gjitha parakushtet sipas nenit 253, paragrafi 1 LPK dhe taksat gjyqësore të paguara në pajtim me nenin 253, paragrafi 4 LPK. Të gjitha veprimet procedurale të provave duhet të persëriten me jo parregullsi në përfaqësimin e palëve. Vërtetësia e dëftesës së paguar, të datës 3 shtator 2002 duhet të vërtetohet nga ekspertza mjeko ligjore në pajtim me nenin 319, paragrafi 3 LPK. Deklaratat e avokatit HASAN REXHA pas propozimit dëshmues përkatës duhet të dëgjohet vetëm pas përmbushjes së kritereve sipas neneve 339 – 355 LPK për marrjen në pyetje të tij si dëshmitar. Dëshmia e mbledhur në rigjykim duhet të vlerësohet individualisht dhe si tërësi me vlerat e saja dëshmuese siç është paraparë nga neni 8 i LPK.

Në bazë të arsyes së sipërpërmendur është vendosur si në dispozitiv.

**MJETI JURIDIK:** Asnjë ankesë nuk është e lejuar kundër këtij aktvendimi.

**GJYKATA E QARKUT NE PRISHTINË**

**AC. nr.822/2011 Më 23.02.2012**

**KRYETARJA E TRUPI GJYKUES**

________________________

**ROSITZA BUZOVA**

REPUBLIKA E KOSOVËS GJYKATA E QARKUT-PRISHTINË OKRUŽNI SUD - PRIŠTINA REPUBLIKA KOSOVO

**Përkthyer nga anglishtja ne shqip nga:**

**DAUT LATIFAJ, Përkthyes ne EULEX**

________________________

*Përgaditur në Anglisht si gjuhë zyrtare në pajtim me nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në KOSOVË*

## SHENIM MBI KESHILLIMIN DHE VOTIMIN

**GJYKATA E QARKUT NE PRISHTINË** në trupi gjykues të përbërë nga Gjyqtarja Civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtarja MEDIHA JUSUFI dhe Gjyqtari NEHAT IDRIZI si anëtarë të trupit gjykues, më 23 shkurt 2012 këshilluan dhe votuan në mënyrë unanime sikurse në dispozitiv.

Shënimi aktual iu është shtuar aktvendimit AC.nr.822/2011 të Gjykatës së Qarkut në PRISHTINË, të datës 23 shkurt 2012 sipas nenit 140, paragrafi 1, fjalia e dytë LPk.

**GJYKATA E QARKUT NE PRISHTINË**

**AC.nr.822/2011 më 23.02.2011**

______________________

**ROSITZA BUZOVA**

**Kryetare e Trupit Gjykues**

______________________

**MEDIHA JUSUFI**

**Anëtare e Trupit Gjykues**

______________________

**NEHAT IDRIZI**

**Anëtar i Trupit Gjykues**

______________________

**ANDRES MORENO**

**Zyrtar Ligjor i EULEX-it**

______________________

**DAUT LATIFAJ**

**Interpret/Përkthyes (Anglisht/Shqip)**

______________________

**JELENA JANCIĆ**

**Interprete/Përkthyese (Anglisht/Serbisht)**

*Përgaditur në Anglishte si gjuhë zyrtare në pajtim me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe e nënshkruar nga Gjyqtarët kosovarë pas përkthimit nga interpretetët/përkthyesit e referuar më lartë.*